

URDHËR
Nr. 344, datë 6.6.2023

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë; të nenit 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 8318, datë 1.4.1998, “Për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore”, të ndryshuar; pika 20, e kreut IV “Procedurat që ndiqen për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”, të vendimit nr. 373, datë 20.6.2018, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës së nënshkrimit të kontratave të qirasë së tokës bujqësore në pronësi të shtetit, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, z. Mirgen Dobruna, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm (i komanduar).
 2. Delegimi i kompetencave mbaron me revokimin e aktit të delegimit.
 3. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm (i komanduar).
 4. Urdhri nr. 311, datë 29.6.2022, i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural “Për delegim kompetencash”, shfuqizohet.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca